



Co-funded by the
European Union

CN 2021/424879
Support to the promotion of Civil Society regional actions in the Western Balkans



PROMOVIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRMJET AKTORËVE TË SHOQËRISË CIVILE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Maj 2023



PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
HYRJE.....	4
METODOLOGJIA.....	5
1. PERCEPTIMI PUBLIK NDAJ KORRUPSIONI SHQIPËRI, KOSOVE DHE SERBI.....	6
• 1.1 NDIKIMI I KORRUPSIONIT NË NIVELIN E JETËS, PROBLEMATIKAT KRYESORE (DURRËS, LIPJAN, SMEDERVO).....	7
• 1.2 "BASHKEJETESE" ME KORRUPSIONI APO MUNGESË STRATEGJISH DHE VULLNETI PER TA LUFTUAR?.....	9
• 1.3 PRESIONI I ADMINISTRATËS DHE DETYRIMI PER TE PAGUAR RRYSHFET.....	11
2. PERCEPTIMI PUBLIK MBI PROCEDURAT E RAPORTIMIT TE KORRUPSIONIT.....	14
• 2.1 SHKALLA E RAPORTIMIT DHE ARSYET KRYESORE QE NDIKOJNE.....	15
• 2.2 PROBLEMATIKAT KRYESORE SA I TAKON SHËRBIMEVE PUBLIKE BAZË.....	17
3. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	20
• 3.1. DISA PËRFUNDIME KRYESORE.....	20
• 3.1. DISA REKOMANDIME KRYESORE TE TE ANKETUARVE.....	21
REFERENCA.....	22

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Vlerësimi mbi detyrimin për të paguar rryshfet.....	12
Tabela 2. Vlerësimi i procesit të raportimit.....	15
Tabela 3. Shkaqet e mosraportimit të rasteve korruptive.....	16

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Vlerësimi i perceptimit të korrupsionit sot.....	6
Figura 2. Vlerësimi i prirjes së korrupsionit në krahasim me 10 vite më parë.....	7
Figura 3. Standarti aktual i jetesës sot.....	7
Figura 4. Standarti i jetesës i krahasueshëm me tre vite më parë.....	8
Figura 5. Vlerësimi i sfidave më serioze në qytetet përkatëse.....	9
Figura 6. Ushtruesit e korrupsionit.....	9
Figura 7. Vlerësimi për pohimin e parë.....	10
Figura 8. Vlerësimi për pohimin e dytë.....	11
Figura 9. Vlerësimi për pohimin e tretë.....	11
Figura 10. Skenaret e mundshëm për ofrimin e rryshfetit.....	13
Figura 11. Procesi i raportimit të korrupsionit.....	14
Figura 12. Aktet korruptive nga punonjësit e admkinistratës.....	15
Figura 13. Raportimi i akteve korruptive.....	16
Figura 14. Referimet në spitale private.....	17
Figura 15. Referimet dhe personeli.....	18
Figura 16. Reduktimi i faturave nëpërmjet pagesës së rryshfetit.....	18
Figura 17. Përnirësimi i qëndrueshmërisë së shërbimit pas pagesës së rryshfetit.....	19

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Korrupsioni është një ndër fenomenet më të ndeshura dhe të dëgjura, i cili mund të konsiderohet si një tipar i përbashkët i vendeve të Europës Lindore dhe veçanërisht Ballkanit Perëndimor. Studime të shumta lokale dhe ndërkombëtare janë realizuar për këtë aspekt të qeverisjes duke u përpjekur të hedhin dritë në cepat më të errët të tij, por lufta vazhdon. Ky raport ka për qëllim studimin e korrupsionit në nivel lokal me synimin identifikimin e problematikave specifike që qytetarët e tre qyteteve dytësore të Shqipërisë, Kosovës dhe Serbisë ndeshin në përditshmërinë e tyre dhe mbi këtë bazë edhe formulimin e disa rekomandimeve dhe nxjerrjen e praktikave më të mira të një vendi kundrejt tjetrit.

Për zbatimin e këtij projekti qytetet e përzgjedhur janë qyteti i Durrësit në Shqipëri, Smederevo në Serbi dhe Lipjan në Kosovë. Të dhënat e grumbulluara nëpërmjet vrotimit në keto qytete janë analizuar në dy aspekte: (a) korrupsioni dhe (b) qeverisja e mirë duke ndjekur të njëjtën metodologji njëkohësisht në të tre qytetet.

• Korrupsioni në regresion

Korrupsioni konsiderohet si problem serioz dhe shumë serioz nga më shumë se $\frac{3}{4}$ e respondentëve në secilin prej vendeve (80,4% në Shqipëri, 74,6% në Kosovë dhe 79,4% në Serbi) dhe progresi i tij përgjatë 10 viteve të fundit konsiderohet si më keq dhe shumë më keq nga 71,7% e respondentëve në Shqipëri dhe 57,9% në Serbi.

• Vullneti i munguar politik për të luftuar korrupsionin nga qeveritë e vendeve

Vullneti politik për luftimin e korrupsionit nga qeveritë e vendeve ku është zhvilluar studimi perceptohet në shifra shumë të ulëta (72% e respondentëve në Shqipëri nuk kanë besim tek vullneti politik i qeverisë, 66% në Shqipëri dhe 36% në Kosovë).

• Detyrimi për të paguar ryshfet për të përfituar shërbimet bazë

Pothuajse $\frac{1}{2}$ e respondentëve në Shqipëri dhe Serbi deklarojnë se ju është dashur të paguajnë ryshfet për të marrë shërbime bazë, leje apo liçenca, për të përshpejtuar proceset gjyqësore apo për të rishikuar taksat. Në Kosovë ky fenomen ndeshet më rrallë dhe respondentët kanë zgjedhur në shumicën e rasteve të mos përgjigjen.

• Sistem shëndetësor i korruptuar

Një pjesë e respondentëve referohen drejt klinikave private nga mjekët e spitaleve shtetërore ku ata afrohen për të përfituar shërbimin e nevojshëm dhe në këto raste referimi më shumë se $\frac{1}{2}$ e respondentëve (77,3% në Shqipëri, 70% në Kosovë dhe 50,5% në Serbi) konfirmojnë se janë ndeshur me të njëjtin personel në klinikën private ku janë referuar.

• Mungesë informacioni mbi procedurat e raportimit të akteve korruptive

Pjesa dërrmuese e respondentëve në të tre qytetet nuk dinë se çfarë procesi duhet ndjekur për të raportuar një akt korruptiv (69,8% në Serbi, 69,7% në Shqipëri dhe 19% në Kosovë).

• Sistem raportimi joefiçent, i komplikuar që nuk ofron mundësi mbrojtjeje nga hakmarrjet e mundshme

Më shumë se $\frac{1}{2}$ e respondentëve në secilin prej vendeve e vlerësojnë sistemin e raportimit të korrupsionit si jo efektiv, të komplikuar dhe ndihen të pambrojtur kundrejt hakmarrjeve të mundshme që mund të vijnë si pasojë e raportimit. Respondentët në Kosovë zgjedhin kryesisht të qëndrojnë indiferent apo të mos ju përgjigjen pyetjeve të këtij lloji.#

• Shkaqet kryesore të mosraportimit të rasteve korruptive

Shkaqet kryesore se përse qytetarët zgjedhin të mos raportojnë rastet e korrupsionit janë:

- Është e vështirë që të provohen/sigurohen prova se rasti vërtetë ka ndodhur (66% në Shqipëri, 62,9% në Serbi, 17% në Kosovë);
- Nuk ka asnjë përpjeke për përmirësim edhe në rastet kur merren vendime (73,7% në Shqipëri, 66,7% në Serbi dhe 14% në Kosovë);
- Shqetësimet të cilat vijnë si pasojë e frikës nga hakmarrjet e mundshme (82,8% në Serbi, 76,2% në Shqipëri dhe 11% në Kosovë);

HYRJE

Ky raport paraqet rezultatet e një prej tre sondazheve të kryera si pjesë e projektit të Western Balkans Fund (WBF) “Promovimi i Bashkëpunimit Ndërmjet Aktorëve të Shoqërisë Civile në Luftën Kundër Korrupsionit.”, i cili synon forcimin e kapaciteteve lokale në mbështetje të ndërgjegjësimit qytetar në luftën kundër korrupsionit. Projekti fokusohet në tre vende të Ballkanit Perëndimor dhe zbatohet respektivisht nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike në Shqipëri, Instituti i Kërkimeve Kundër Korrupsionit (KAPEJA) në Serbi dhe Organizata “ÇOHU” në Kosovë.

ACER dhe ÇOHU janë organizata të shoqërisë civile antare të rrjetit SELDI (Southeast European Leadership for Development and Integrity) projekt i cili është krijuar para më shumë se një dekade dhe është i fokusuar në fushën e anti-korrupsionit dhe të qeverisjes së mirë, aktualisht i përbërë nga 39 anëtarë dhe bashkëpunëtorë. Përvoja e SELDI-it i ka ndihmuar dy organizatat partnere në përshtatjen e metodologjisë së këtij projekti, përkatësisht të metodologjisë për monitorimin e korrupsionit CMS (Corruption Monitoring System).

Në përgjithësi, vendet e Ballkanit Perëndimor që vijnë nga një e kaluar e përbashkët komuniste vuajnë praninë dhe pasojat e fenomenit të korrupsionit. Sipas Transparency International (TI) korrupsioni në të tri vendet e analizuar vazhdon të jetë një problem serioz. Nëse shohim indeksin e përvitshëm të korrupsionit për të tre vendet e përfshira në projektin e mbështetur nga WBF, vihet re se, në periudhën 2018 - 2022, konstatohet se indeksi i perceptimit të korrupsionit varion nga (35) në (38) në një shkallë nga 0 në 100 ku 100 është shumë i pastër dhe 0 është shumë i korruptuar, dmth të tre vendet janë pozicionuar një renditje të ulët në krahasim me pjesën tjetër të botës.

Reduktimi i korrupsionit dhe përmirësimi mbi këtë bazë i qeverisjes është një prej parakushteve të perparimit ekonomik dhe shoqëror dhe antarësimit në Bashkimin Evropian, prandaj qeveritë e vendeve respektive bëjnë përpjekje për një luftë të suksesshme kundër korrupsionit, i cili vlerësohet se është i pranishëm në të gjitha fushat e jetës. Në progres raportet vjetore të Bashkimit Evropian korrupsioni vazhdon të mbetet një pengesë kryesore për integrimin e mëtejshëm të vendeve të marra në analizë.

Nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, synohet që mbi bazën e perceptimit të qytetarëve në bashkitë respektive të paraqiten pikëpamjet dhe perspektivat e përgjithshme mbi korrupsionin dhe ndikimin e tij në cilësinë e shërbimeve publike të ofruara. Përfundimet e arritura nga vrojtimi anti-korrupsion i ndërmarrë nëpërmjet këtij projekti, vlerësohet se mund të përdoret për të iniciuar, vlerësuar dhe ndërmarrë reformat e nevojshme që mbështesin mirëqeverisjen vendore dhe që janë të zbatueshme në secilin vend.

METODOLOGJIA

Vrojtimi ndjek një qasje me tre hapa: - së pari, u identifikuan qytetet potenciale se ku do të zhvillohej vrojtimi. Grupimi dhe përzgjedhja u bë mbi bazën e indikatorëve të tillë si përputhja me objektivat e projektit, dmth u zgjodhën qytete me madhesi mesatare (jo kryeqytetet e vendeve pjesëmarrëse në projekt), qytete të cilat ndodhen jo shumë larg kryeqytetit, me popullsi dhe tregues të përafërt me kryeqytetin, prania e identifikueshme përmes denoncimeve të mas-medias në lidhje me korrupsionin në nivel lokal, etj. Qytetet e përzgjedhura, mbi bazën e këtyre kriterëve janë respektivisht: Durrës (Shqipëri), Smederevo (Serbi) dhe Lipjan (Kosovë).

Më pas, nisur edhe nga disponibiliteti i të dhënave të detajuara demografike të secilit nga qytetet e përzgjedhura ku do të zbatohet projekti, u ndërtua dhe u testua draft-pyetësori që u përdor për vrojtimin. Pas kësaj, vrojtimi u realizua njëkohësisht në të tri vendet (qytetet) pjesëmarrëse në projekt. Intervistat u realizuan ballë për ballë sipas metodës përmes metodës së CAPI (Intervistave të Asistuar nga Kompjuteri) dhe pyetësoret u rregjistruan në sistemin e transmetimit të të dhënave të ACER.

Pyetësori u ndërtua mbi bazën e një metodologjie të zbatuar të njohur nga një studim i ngjashëm i mbështetur nga Këshilli i Evropës. Duke qenë se fokusi i projektit aktual është mbi korrupsionin në nivel lokal, ACER sebashku me partneret e projektit bënë disa modifikime në përmbajtjen e anketës duke ruajtur pjesët kryesore që kanë të bëjnë me anti-korrupsionin, por duke ndryshuar disa nga opsionet e përgjigjeve që lidhen me specifikat e vendeve pjesëmarrëse. Kampioni i përdorur përfshin popullsinë e rritur rezidente të bashkive përkatëse që jeton në si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane.

Në përfundim të vrojtimit, rezultatet e intervistave dhe gjetjet e studimit u analizuan përmes programit SPSS për të ofruar një pamje të përgjithshme të detajuar të situatës së korrupsionit në nivel vendor, si dhe të aktiviteteve dhe të rekomandimeve politike që qytetarët mendojnë se duhet të ndërmerren nga pushteti vendor në secilin vend pjesëmarrëse në projekt.

TRAJNIMI DHE PUNA NË TERREN

Ndër aktivitetet e para të projektit ka qenë trajnimi i përfaqësuesve të organizatave partnere zbatuese të projektit, i zhvilluar në Prishtinë. Trajnimi konsistonte në qartësimin e metodologjisë së projektit në mënyrë që të tre organizatat partnere të mund të siguronin të dhëna të krahasueshme midis tyre. Pas qartësimit të metodologjisë dhe përzgjedhjes së pyetësorit, secili prej partnerëve ka përzgjedhur individët të cilët do të angazhoheshin me plotësimin e pyetësorëve në zonat respektive, për të realizuar numrin e përcaktuar të intervistave (450 intervista në secilin vend). Me qëllim që intervistuesit ta përvetësonin pyetësorin dhe të kuptonin metodologjinë e projektit, partnerët kanë zhvilluar një trajnim të posaçëm të tyre duke shpjeguar në detaje çdo seksion të pyetësorit si dhe teknikën e adresimit të pyetjeve dhe dokumentimit të përgjigjeve përmes tablet PC për transmetimin në sistemin e ACER.

Metoda e përzgjedhur për të përfutur një kampion rastësor është ajo e “derës së shtatë”. Sipas kësaj metode, pas fiksimit të kufijve të grupimit, intervistuesit zgjedhin një vend të rastësishëm nga do të fillojë intervistimi dhe më pas vazhdohet sistematikisht prej andej. Pasi zgjidhet një derë (shtëpi/apartament) në mënyrë rastësore, intervistuesit e përzgjedhin derën e rradhës duke përdorur këtë metodë. Pra pasi vendoset paraprkisht shtëpia që do të mbajë numrin 1, shtëpia e rradhës zgjidhet ajo me numrin 7 e kështu me rradhë (diferenca nga një derë tek tjetra duhet të jetë 6). Kjo bëhet në funksion të shpërndarjes së kampionit i cili merret në intervistë.

Pasi ka qenë identifikuar familja që do të intervistohet, i intervistuari në atë familje duhet të jetë: moshë mbi 18 vjeç dhe të kishte ditëlindjen më të afërt. Në këtë mënyrë çdo intervistë e kryer nga intervistuesi u ngarkua automatikisht menjëherë në serverin e dedikuar, të vendosur në ambientet e ACER. Baza e të dhënave u përditësua në mënyrë progresive në server dhe mundësoi kontrollin periodik të ecurisë së procesit të grumbullimit të të dhënave.

ORGANIZIMI I KËTIJ RAPORTI

Ky raport në mënyrë që të shpreh në formë të qartë dhe të kuptueshme gjetjet e të tre vendeve të marra në analizë nga lexuesit e jashtëm, është ndarë në disa nënçështje të cilat janë si më poshtë vijon:

Nënçështja e pare ka të bëjë me perceptimin publik ndaj korrupsionit në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi. Kjo nënçështje përfshin brenda saj ndikimin e korrupsionit në nivelin e jetesës, problematikat kryesore (Durrës, Lipjan, Smederevo) si edhe shtron pyetjen: “Bashkëjetesë me korrupsionin apo mungesë strategjish dhe vullnet për ta luftuar?”. Kjo nënçështje gjithashtu mbulon edhe presionin e administratës dhe detyrimin për të paguar rryshfet. Të gjitha këto pika shikohen në kontekstin vendor, duke u krahasuar midis tre vendeve ku është fokusuar projekti.

Nënçështja e dytë fokusohet tek perceptimi publik mbi procedurat e raportimit të korrupsionit duke dhënë një tablo të qartë të asaj çfarë mendojnë dhe njohurive të respondentëve mbi procesin e ankimit të akteve korruptive në administratën publike, nën panoramën e krahasimit midis tre qyteteve dhe vendeve. Më tej kjo nënçështje analizon shkallën e raportimit dhe arsyet kryesore që e ndikojnë në mosraportim edhe në rastet kur ka arsye për ta bërë diçka të tillë (siç mund të jenë rastet e kërkimit të rryshfetit në mënyrë të drejtpërdrejtë). Një tjetër fokus i kësaj nënçështjeje janë edhe problematikat kryesore sa ju takon shërbimeve publike bazë të cilat janë një nevojë vitale për qytetarët e kujtdo vendi.

Nënçështja e tretë reflekton përfundimet dhe rekomandimet kryesore të raportit, me fokus në gjetjet e të tri vendeve respektive. Kjo nënçështje jep fillimisht gjetjet apo përfundimet kryesore të raportit dhe më tej vijon me rekomandimet kryesore të të anketuarve në secilin prej qyteteve respektive (Durrës, Lipjan dhe Smederevo).


1. PERCEPTIMI PUBLIK NDAJ KORRUPSIONIT NË SHQIPËRI, KOSOVË DHE SERBI

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë vende të cilat janë karakterizuar nga nivele të larta të korrupsionit dhe presionit të tij ndër vite. Mund të përmendim gjetjet e vrojtimit rajonal mbi bazën e sistemit të Monitorimit të Korrupsionit të zbatuar nga projekti SELDI me të njëjtën metodologji prej vitit 2002, nga ku rezulton se të tre shtetet e marra në analizë kanë presion të lartë korrupsionit. Në gjetjet e raportit të fundit të CMS (2021), rezulton se përqindja e mundësisë për presion të korrupsionit është respektivisht 64% për Shqipërinë, 63% për Kosovën dhe 55% për Serbinë. CMS, ndryshe nga ky studim, është i shtrirë në nivel kombëtar në vendet respektive dhe të dhënat krahasohen midis tyre.

Pavarësisht shtrirjes më të gjerë të CMS, të dhënat mbi nivelin e korrupsionit nga vrojtimi i realizuar vetëm në një qytet të secilit vend nga projekti i mbështetur nga WBF rezultojnë të përafërta me ato të SELDI-it të fundit, dmth perceptimi i qytetarëve mbi këtë fenomen të korrupsionit është i ngjashëm. Siç mund të kuptohet edhe nga Figura 1 më poshtë perceptimi i korrupsionit si problem serioz dhe shumë serioz është ende shumë i lartë në të tre vendet, respektivisht 80,4% në Shqipëri, 74,6% në Kosovë dhe 79,4% në Serbi. Shqetësues mund të konsiderohet fakti se megjithëse Kosova është shteti më i ri nga vendet e marra në analizë, vlerësimi për fenomenin e korrupsionit është shumë i përafërt me dy vendet e tjera, Shqipëria dhe Serbia (me diferencë -4,8% me Serbinë dhe -5,8% me Shqipërinë).

Në Kosovë vihet re edhe një numër më i lartë i personave që zgjedhin të mos përgjigjen duke zgjedhur opsionin “Nuk e di/refuzoj të përgjigjem”, në nivelin 7,3%. Kjo tregon një hezitim për t’u përgjigjur i cili mund të vijë nga mungesa e informacionit apo nga rezervimi për t’u përgjigjur për arsye të ndryshme, duke përfshirë mosbesimin për të folur hapur edhe rreth këtij fenomeni.

Figura 1. Vlerësimi i perceptimit të korrupsionit sot.




Në vlerësimin e prirjes së korrupsionit të krahasuar me 10 vite më parë (shih Figurën 2) diferencat ndërmjet vendeve duket se janë më diverse. Në një vlerësim me 4 shkallë mbi trendin e korrupsionit ku 1 – shumë më keq dhe 4 – pakësuar shumë, progresin më të madh në luftën kundër tij, mund të thuhet plotësisht që e ka Kosova me një vlerësim prej 41,9% për grupet e përgjigjeve pakësuar dhe pakësuar shumë, në ndryshim nga Shqipëria dhe Serbia që kanë shifra shumë më të ulëta për këto opsione, (respektivisht 3,7% në Shqipëri dhe 4,2% në Serbi). Të dhënat e Kosovës tregojnë se është perceptimi i përgjithshëm i popullsisë se korrupsioni po vjen duke u zögëluar, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin publik ndaj qeverisjes si edhe tek drejtësia.

Ndërkohë situata është e ndryshme në rastin e Shqipërisë ku perceptimi mbi korrupsionin ka pësuar regresion të theksuar me 71,7% të respondentëve të cilët e vlerësojnë nivelin e korrupsionit si më keq dhe shumë më keq në krahasim me 10 vitet e fundit. Një situatë e ngjashme vihet re edhe në Serbi me 57,9% të respondentëve të cilët e vlerësojnë trendin e korrupsionit si më keq dhe shumë më keq, shifra të cilat përsëri konsiderohen të larta dhe me diferencë domethënëse me Kosovën e cila ka shifrën 23,9% për këtë tregues.

Diçka tjetër që vihet re është fakti se Shqipëria duket se ka shënuar një progres të ulët e të parëndësishëm duke mbetur në vend-numëro, me vetëm 22,7% të respondentëve të cilët e vlerësojnë korrupsionin në nivel të njëjtë me 10 vite më parë, ndryshe nga Kosova e cila ka shifrën 31,2% dhe Serbia respektivisht 28,5% për të njëjtin tregues.

Ngjarjet politike të viteve të fundit duket se e kanë influencuar shumë Serbinë dhe Shqipërinë duke ulur besimin tek vullneti politik për të luftuar korrupsionin, ndërkohë që Kosova edhe pse shteti më i ri në analizë, ka shënuar një progress domethënës në përmirësimin e perceptimit qytetar kundrejt fenomenit të korrupsionit.

Figura 2. Assessment of the trend of corruption compared to 10 years ago




1.1 Ndikimi i korrupsionit në nivelin e jetës, problematikat kryesore (Durrës, Lipjan, Smedervo)

Respondentët janë pyetur se si e vlerësojnë nivelin e tyre aktual të jetesës (Figura 3) dhe në krahasim me 3 vite më parë (Figura 4). Sa i takon vlerësimin për nivelin aktual të jetesës, vihet re një prirje e ngjashme për opsionin “pothuajse njësoj (fair)” për të trija vendet pasi shifrat më të larta respektive janë për këtë opsion zgjedhje (50% në Kosovë, 48% në Serbi dhe 45% në Shqipëri).

Prirjen më pozitive duket se e shfaq Serbia me vetëm 1% të respondentëve që vlerësojnë nivelin e tyre aktual të jetesës në krahasim me 3 vite më parë keq/shumë keq krahasimisht me Kosovën ku 35% e respondentëve e kanë zgjedhur si opsion dhe me Shqipërinë (33%). Kjo diferencë midis Serbisë dhe dy vendeve të tjera tregon se masat qeveritare për përballimin e krizes sidomos sa i takon punësimit dhe mbështetjes sociale kanë qenë më efektive se masat e ndërmarra në dy vendet e tjera. Diçka tjetër që vlen të përmendet është fakti se perceptimi i njerëzve mbi nivelin e jetesës karakterizohet nga doza të subjektivitetit sepse kushtëzohet nga niveli i tyre kulturor apo mjedisi social-ekonomik në të cilin jetojnë, prandaj diferencat në opinione janë të pranueshme aq më tepër për analiza krahasuese nga një vend në tjetrin.

Figura 3. Standarti aktual i jetesës




Ndërkohë sa i takon krahasimit të nivelit aktual të jetesës me 3 vjet më parë (Figura 4), vihet re se pesha specifike e respondentëve është e ngjashme në Serbi dhe në Shqipëri sa i takon opsionit “pothuajse njësoj” i cili ka frekuencën më të lartë të përgjigjeve, përkatesisht 51% në Serbi dhe 43,9% në Shqipëri (33% në Kosovë), ndërkohë që Kosova frekuencën më të lartë e ka për opsionin më keq tani/shumë më keq tani, përkatesisht me një përqindje të përgjigjeve prej 42% krahasuar me 28,7% Shqipëria dhe 5,5% Serbia.

Edhe në pyetjen në lidhje me nivelin aktual të jetesës Kosova kishte frekuencën më të lartë të respondentëve që kanë zgjedhur keq/shumë keq (35%) dhe Serbia shifrën më të ulët (1%). Këto diferencat tregojnë një situatë shqetësuese ekonomike aktuale dhe se qeveria

e Kosovës nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur mbajtjes së premtimeve të saj për përmirësim e standardit të jetesës së qytetarëve të saj dhe se pritshmëritë e qytetarëve janë më të larta se ato të vendeve fqinje me ta.

Ndërkaq Serbia duket se ka performancën më të mirë për këtë fushë me 43% të respondentëve të cilët e konsiderojnë standartin e jetesës më mire/shumë më mirë se tre vite më parë krahasuar me Shqipërinë (26,9%) dhe Kosovën (25%). Prirja duket se është e ngjashme si për nivelin aktual të jetesës (Figura 3) ashtu edhe për atë të krahasueshmin ndër vite (Figura 4).

Figura 4. Standarti i jetesës i krahasueshëm me tre vite më parë




Respondentët janë pyetur se çfarë vlerësojnë si sfidën më serioze të qytetit të tyre nga një listë problemesh (Figura 5) nga ku vihet re se korrupsioni dhe destabiliteti politik është një ndër problematikat kryesore të konstatuara më së shumti në Serbi (10%) por edhe në Shqipëri (7%). Këto të dhëna korrespondojnë edhe me vlerësimin e vitit të fundit (2021) të Bankës Botërore për Indikatorët Mbarëbotëror të Qeverisjes ku vendet e marra në analizë kanë rënditje të dobët në fushat e stabilitetit politik dhe kontrollit të korrupsionit.

Nga ana tjetër problematika si niveli i dobët dhe çmimet e larta të shërbimeve shëndetsore konsiderohen fenomene shqetësuese për Shqipërinë (6%) dhe Kosovën (5%) ndërkohë që në Serbi vetëm 1% e respondentëve e zgjedhin këtë problem kundrejt të tjerëve. E njëjta situatë ndeshet edhe me problematikën e migrimit ku në Shqipëri është zgjedhur si problemi më serioz nga 6% e respondentëve, po ashtu 6% edhe në Kosovë, ndërkohë që në Serbi është zgjedhur vetëm nga 1% e respondentëve. Këto rezultate duket se vijnë si pasojë e nivelit relativisht më të lartë të jetesës së Serbisë në krahasim me dy vendet e tjera, të pasqyruar edhe në analizën e mësipërme, të cilat bëjnë që këto fenomene të mos jenë në listën e problemeve serioze më emergjente për vendin.

Në rastin e Shqipërisë, këta dy tregues (korrupsioni dhe destabiliteti politik niveli i dobët dhe çmimet e larta të shërbimeve shëndetsore) janë në një lidhje llogjike midis tyre: sa më i ulët niveli i shërbimit shëndetësor publik, aq më shumë do të shpenzojnë qytetarët në spitale private apo edhe jashtë shtetit për të marrë shërbimin që ata shikojnë të përshtatshëm. Koston e këtij te fundit e rrit edhe ekzistenca e partneriteteve publike-private si edhe mangësitë në skëmen e kujdesit shëndetësor, në të cilën të punësuarit kontribuojnë, por shërbimet që ju kthehen janë në nivele të papërfillshme.

Në Serbi vihet re se ka një numër të konsiderueshëm respondentësh të cilët kanë zgjedhur opsionin “Tjetër” (19%) kur janë pyetur për të zgjedhur problemin më serioz të vendit, ndryshe nga Shqipëria (6%) dhe Kosova (3%). Me sa duket problematikat e shoqërisë së këtij vendi janë më të gjera dhe se respondentët nuk e kanë gjetur problemin më shqetësues të tyre në listën e ofruar në pyetësinë e vrojtimit.

Figura 5. Vlerësimi i sfidave më serioze në qytetet përkatëse



1.2. “Bashkejetese” me korrupsioni apo mungese strategjish dhe vullneti per ta luftuar?


Për të kuptuar më tepër qasjen e respondentëve ndaj korrupsionit dhe se kujt ia atribuon ata fenomenin, të intervistuarit janë pyetur se nga cili grup ushtrohet më tepër korrupsioni (Figura 6). Grupi i cili ka frekuencën më të lartë të zgjedhjes në të treja vendet janë politikanët, i zgjedhur përkatësisht Shqipëria - 58%, Serbia - 52% dhe Kosova - 46%. Lufta kundër korrupsionit lidhet me vullnetin politik në perceptimin qytetar dhe për rrjedhojë gjithë drejtohet drejt politikanëve.

Ajo çfarë vihet re tjetër është perceptimi më i lartë në Shqipëri se korrupsioni ushtrohet edhe nga zyrtarët (31%), shifër e cila mund të argumentohet me faktin se Shqipëria është një vend me nivele të larta të patronazhimit partiak dhe nepotizmit, në kundërshtim me shifrën dukshëm më të ulët të këtij perceptimi në Serbi (11%), duke lënë të kuptohet se administrata serbe mund të jetë me eficientë në ofrimin e shërbimeve publike në nivel lokal.

Pozitive për Serbine konsiderohet edhe perceptimi se përgjegjës për fenomenin e korrupsionit janë edhe qytetarët (15%) që bashkëveprojnë, duke lënë të kuptohet se ndërgjegjësimi i popullsisë për këtë faktor është më i lartë se në dy vendet e tjera ku shifrat për këtë tregues janë vetëm 2% (Shqipëri) dhe 4% (Kosovë).

Numri më i lartë në Kosovë i personave që nuk përgjigjen nuk e di/refuzojnë të përgjigjen, tregon se ndërgjegjësimi për efektet e korrupsionit është me i vogël dhe se presioni kundër denoncuesve të korrupsionit është më i lartë.

Figura 6. Ushtresit e korrupsionit




1.2.1 Korrupsioni pjese e jeteses se perditshme apo mungojne strategjite efikase dhe vullneti per ta luftuar?

Respondentët janë pyetur për të vlerësuar tre pohime të ndryshme mbi korrupsionin me një shkallë nga 1-5 ku 1 – aspak dakord dhe 5 – plotësisht dakord. Priorja për të tre vendet është e ngjashme për secilin prej pohimeve, me diferenca të vogla ndërmjet tyre. Analizat e detajuara të secilit prej tyre jepen në vijim.

Pohimi i parë ka të bëjë me trajtimin e korrupsionit si një fenomen rutinë duke konsideruar denoncimin e tij si të panevojshëm (Figura 7), për të cilin shumica e respondentëve në të tre vendet (respektivisht 81% në Serbi, 74% në Shqipëri dhe 66% në Kosovë) nuk janë dakord dhe aspak dakord me pohimin. Këto shifra janë pozitive pasi tregojnë që po ndodh një ndërgjegjësim në rritje i qytetarëve për të luftuar korrupsionin, në të tre vendet, duke marrë parasysh faktin se është një ndër fenomenet i cili mbetet edhe pengesa kryesore për integrimin në Bashkimin Europian (Serbia dhe Shqipëria janë aktualisht me statusin e vendit kandidat).

Shqetësuese janë pjesa tjetër e respondentëve, kryesisht në Shqipëri dhe Kosovë, të cilët kanë zgjedhur opsionet plotësisht dakord/dakord dhe indiferent (23% në Kosovë, 25% në Shqipëri dhe 13% në Serbi), ku pothuajse ¼ e respondentëve e shohin korrupsionin si një fenomen rutinë i cili nuk duhet luftuar/denoncuar. Për këtë arsye, në këto vende duhet forcuar roli i organizatave të shoqërisë civile për ndërgjegjësimin e popullsisë mbi efektet negative që sjell korrupsioni në jetesën e tyre, nevojën për ta denoncuar atë si dhe mënyrat e adresimit të ankesave të tyre.


Figura 7. Vlerësimi për pohimin e parë



Pohimi i dytë ka të bëjë me vullnetin politik për të luftuar korrupsionin në qeveritë e vëndeve përkatëse nga ku vëmë re se shumica e respondentëve në Shqipëri dhe Serbi janë dakord dhe plotësisht dakord se mungon vullneti i sinqertë politik (72% në Shqipëri dhe 66% në Serbi), shifra këto të cilat tregojnë besueshmëri të ulët të qytetarëve ndaj qeverisë. Ky mosbesim lidhet edhe me gjetjet paraardhëse mbi ushtruesit e korrupsionit, ku peshën më të madhe e zinin politikanët.

Vihet re se Kosova ka numrin më të ulët të respondentëve të cilët janë dakord dhe plotësisht dakord me pohimin (36%) dhe numrin më të lartë të respondentëve të cilin zgjedhin opsionet indifferent/jo dakord dhe aspak dakord (54%), duke nënkuptuar me këtë faktin se qytetarët kosovarë kanë më shumë besim se qeveria ka vullnet politik dhe po bën përpjekje për ta luftuar korrupsionin në vënd. Këto diferenca midis vëndeve ndikohen edhe nga fakti se Kosova është shteti më i ri ndërmjet tyre i cili po ndeshet me shumë peripeci dhe vende të cilat akoma nuk e kanë njohur si shtet dhe përpjekjet e Kosovës në këtë drejtim janë më të mëdha.


Figura 8. Vlerësimi për pohimin e dytë



Pohimi i tretë ju kërkon respondentëve të vlerësojnë faktin se strategjitë anti-korrupsion të qeverisë aktuale janë efektive, nga ku një numër i konsiderueshëm respondentësh nuk janë dakord dhe aspak dakord me pohimin (58% në Serbi, 51% në Shqipëri dhe 33% në Kosovë). Ndërkohë që shifrat më të larta të respondentëve të cilët janë dakord dhe plotësisht dakord me pohimin janë në Kosovë (35%) krahasuar me Shqipërinë (26%) dhe Serbinë (24%). Përsëri konstatojmë një qasje më pozitive tek qytetarët e Kosovës të cilët duken se kanë më tepër besim se në dy vendet e tjera se korrupsioni mund të luftohet dhe se qeveria është në mbështetje të tyre në luftën kundër tij.

Ajo çfarë vihet re në këtë pohim është numri i lartë i respondentëve që zgjedhin të qëndrojnë indiferent apo të mos përgjigjen (32% në Kosovë, 25% në Shqipëri dhe 18% në Serbi). Arsyeja pse kjo ndodh mund të jetë fakti se qytetarët nuk kanë informacionin e nevojshëm mbi masat anti-korrupsion që kanë ndërmarrë qeveritë e vendeve të tyre dhe për rrjedhojë zgjedhin të mos përgjigjen apo prenonohen. Këto hapësira të krijuara duhet të shfrytëzohen nga organizatat e shoqërisë civile të vendit për të kontribuar në ndërgjegjësimin e qytetarëve për problematikat që i rrethojnë.

Figura 9. Vlerësimi për pohimin e tretë



1.3 Presioni i administrates dhe detyrimi per te paguar rryshfet

Qytetarët janë pyetur se në çfarë frekuence (sa shpesh) ju është dashur të paguajnë rryshfet për të marrë shërbimin e kërkuar për disa kategori shërbimesh, duke e vlerësuar përgjigjen e tyre me shkallë nga 1-5 ku 1 – kurrë dhe 5 – gjithmonë (Tabela 1). Përgjithësisht vihet re se frekuencat më të larta janë për opsionin e përgjigjes “shpesh” çka do të thote se presionet për rryshfet janë të pranishme në të tre vendet e marra në analizë.

Sa i takon marrjes së shërbimeve bazë vihet re se respondentët nga të tre vendet kanë zgjedhur më tepër opsionin “shpesh” (respektivisht 40,3% në Shqipëri, 34,2% në Serbi dhe 25,9% në Kosovë), ndërkohë që Kosova ka numrin më të lartë të respondentëve që kanë zgjedhur opsionin “kurrë” (16,1%) dhe “nuk e di/refuzoj të përgjigjem” (17,1%). Këto të dhëna janë shqetësuese dhe duhen parë me interes të veçantë pasi pamundësia për të marrë shërbimet bazë pa paguar nën dorë dëshmon keq-qeverisjen dhe mosfunksionim të shtetit në nivele alarmante.

Ndërkohë që për të marrë leje apo liçenca Shqipëria ka numrin më të lartë të respondentëve të cilët zgjedhin opsionin “shpesh” (35,6%), ndërkohë që në Kosovë dhe Serbi numri më i lartë i respondentëve zgjedhin të mos përgjigjen (23,5 % në Kosovë dhe 28% në Serbi). Pavarësisht repondentëve që zgjedhin të mos përgjigjen, të dy vendet kanë përqindje të larta zgjedhje të opsionit “shumicën e rasteve” me respektivisht 21% secili .

Për opsionin e shpejtimit të procedurave gjyqësore, Shqipëria vazhdon të ketë po të njëjtën prirje si në dy pohimet e mësipërme ndërkohë që 39,7% e respondentëve ne Serbi dhe 26,8% e tyre në Kosovë zgjedhin të mos përgjigjen. Kosova ka një përqindje të lartë të respondentëve që zgjedhin opsionin “kurrë” (24,4%) çka do të thotë se sistemi gjyqësor i këtij vendi është më pak i prekur nga korrupsioni në krahasim me dy vendet e tjera që po analizojmë.

Për shërbimin e tatime-taksave shumica e respondentëve në Shqipëri dhe Serbi kanë zgjedhur opsionin se ju është dashur shpesh të paguajnë rryshfet (27,8% në Shqipëri dhe 28,9% në Serbi). Ndërkohë që në Kosovë duket se një numri i konsiderueshëm respondentësh nuk ju është dashur kurrë të paguajnë rryshfet për këtë shërbim (23,9%) dhe pjesa më e madhe zgjedhin të mos përgjigjen (28,3%).

Në përgjithësi administrata e Kosovës duket se është më pak e korruptuara në krahasim me dy vendet e tjera ku shpesh herë qytetarëve ju është dashur të paguajnë rryshfet për të marrë shërbimet bazë.

Tabla 1. Vlerësimi mbi detyrimin për të paguar rryshfet


How frequently do typical households find themselves obliged to give unofficial payments or presents/gifts to public officials?																		
Rate	Never			Seldom			Frequently			Most times			Always			DK/NA		
Country	AL	XK	RS	AL	XK	RS	AL	XK	RS	AL	XK	RS	AL	XK	RS	AL	XK	RS
To obtain basic public services	3.3	16,1	7,3	18.5	23.4	32,9	40.3	25.9	34,2	21.2	14.2	9,7	10.2	3.4	2,0	6.5	17.1	13,9
To obtain licenses or permits	3.8	19,1	9,3	19.4	10.8	9,3	35.6	20.1	25,8	18.7	21.1	21,0	8.9	5.4	6,6	13.6	23.5	28,0
To speed up legal proceedings in the judicial branch	3.1	24,4	7,7	14.5	11.2	15,5	33.6	14.2	27,2	22.0	13.7	7,9	12.7	9.8	2,0	14.0	26.8	39,7
To update/revise tax status	4.7	23,9	4,6	16.5	17.6	11,7	27.8	16.1	28,9	17.6	9.8	19,6	7.3	4.4	19,2	26.1	28.3	15,9

1.3.1 Skenaret e mundshme si zhvillohet korrupsioni

Qytetarët e të tre vendeve janë pyetur se cili është skenari i mundshëm në rastet kur ju bëhet presion të paguajnë rryshfet (Figura 10), nga ku rezulton se skenari më i mundshëm në Shqipëri me pothuajse 1/3 (34%) të respondentëve të cilët e konfirmojnë është se vetë punonjësi i administratës lë të nënkuptohet apo e kërkon vetë pagesën e rryshfetit për të ofruar shërbimin për të cilin paguhet që ta ofrojë. Ndërkohë në Serbi pothuajse ½ (48%) e respondentëve thonë se është e njohur paraprakisht se sa është shuma e parave që duhet të paguhet dhe menyrën se si duhet të paguhet për të marrë shërbimin përkatës publik, pra është një proces rutinë që konsiderohet si diçka e zakonshme dhe është bërë pjesë e kulturës së administratës së vendit.

Kosova, siç u reflektua edhe në analizën e tabelës 1, ka një qasje tjetër pasi shumica e respondentëve (39%) zgjedhin opsionin nuk e di/ refuzoj të përgjigjem. Duke u mbështetur edhe nga gjetjet e mësipërme mund të themi se Kosova është më pak e ndeshur me fenomenin e rryshfetit dhe duket se ka një administratë më funksionale. Sigurisht ka grimca rryshfeti të cilat duken tek 27% e respondentëve që zgjedhin opsionin e dytë dhe 26% të cilët zgjedhin opsionin e parë.

Figura 10. Skenaret e mundshëm për ofrimin e rryshfetit.




2. PERCEPTIMI PUBLIK MBI PROCEDURAT E RAPORTIMIT TE KORRUPSIONIT

Njohja e procedurave te raportimit të akteve korruptive është një ndër shtyllat kryesore për sukses në luftën kundër tij. Për këtë arsye qytetarët janë pyetur mbi njohuritë e tyre mbi rrugën që ata duhet të ndjekin për të raportuar një akt korruptiv nga punonjësit e administratës publike (Figura 11).

Të dhënat, të cilat dalin nga kjo pyetje, janë vërtet shqetësuese pasi 69,7% e respondentëve në Shqipëri dhe 69,8% e respondentëve në Serbi nuk kanë informacion mbi procedurat e raportimit. Vetëm 20% e respondentëve në Kosovë, 30,2% në Serbi dhe 30,3% në Shqipëri kanë njohuri mbi procesin. Me sa duket, pavarësisht përpjekjeve të qeverive për financim për programet e transparencës së institucioneve, efektiviteti i tyre duket se është shumë i ulët. Mungesa e informacionit dhe injoranca e qytetarëve janë habitat i përshtatshëm për formimin dhe mbijetesën e akteve korruptive.

Figura 11. . Procesi i raportimit të korrupsionit



Qytetarët e pakët të cilin kishin njohuri mbi procesin e raportimit të akteve korruptive janë pyetur për të vlerësuar disa aspekte të procesit me një shkallë nga 1 – 5 ku 1 – aspak dakort dhe 5 – plotësisht dakort (Tabela 2). Aspekti i parë që ju është kërkuar të vlerësojnë ishte efektiviteti nëpërmjet një pohimi ku thuhet se procesi ishte shumë efektiv, nga ku rezultojnë se një numër i lartë respondentësh në Serbi (61%) dhe Shqipëri (60%) nuk janë dakort dhe aspak dakort me pohimin. Ndërkohë që trendi në Kosovë duket se është i ndryshëm ku shumica (36%) zgjedhin të mos përgjigjen mirëpo 26% e respondentëve janë dakort dhe plotësisht dakort me pohimin.

Pohimi tjetër mbi procesin që duhet vlerësuar nga respondentët ka të bëjë me lehtësinë e tij, nga ku rezultojnë se 63% e respondentëve në Serbi nuk janë dakort dhe aspak dakort me pohimin; 44% e respondentëve në Shqipëri janë dakort dhe shumë dakort me pohimin ndërkohë që 45% e respondentëve në Kosovë zgjedhin të mos përgjigjen. Shifrat diverse për këtë pohim janë të pritshme duke qenë se proceset janë të ndryshme në zona dhe shtete të ndryshme dhe për rrjedhojë edhe qëndrimi i qytetarit nuk është i njëjtë.

Ndërkohë që sa i takon mbrojtjes së raportuesit nga “hakmarrja”, një numër i lartë respondentësh deklarojnë se nuk ndihen aspak të mbrojtur duke vlerësuar pohimin me shkallën jo dakort/aspak dakort (68% në Serbi, 63% në Shqipëri dhe 35% në Kosovë). Të ndjerit të pambrojtur kundrejt personit tjetër i cili kryen aktin korruptiv në shumicën e rasteve e shtyn personin raportues të mos e kryej deri në fund procedurën e raportimit duke lënë në fuqi një proces inefiçient.

Respondentët në Kosovë vihen re se kanë një stepje për t’ju përgjigjur pyetjeve për procesin e raportimit ku edhe në analizën e mësipërme (Figura 11) kemi një shifër prej 60% të qytetarëve kosovarë që kanë zgjedhur të mos përgjigjen. I njëjti trend vijon edhe në këtë seksion ku për çdo pohim shifra më e lartë është ajo e respondentëve që kanë zgjedhur opsionin nuk e di/refuzoj të përgjigjem. Ky hezitim mund të vijë nga fakti se qytetarët kosovarë nuk janë familjar me këtë proces dhe se ka nevojë të theksuara për informim të shoqërisë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në dy vendet e tjera.

Tabla 2. Vlerësimi i procesit të raportimit


How would you evaluate the process of reporting corruption?												
Country	Completely Disagree / Disagree			Indifferent			Completely agree/ Agree			I do not know/ refuse to answer		
	AL	XK	RS	AL	XK	RS	AL	XK	RS	AL	XK	RS
The process is very effective	60%	17%	61%	24%	21%	15%	16%	26%	19%	1%	36%	5%
The process is very simple	26%	18%	63%	26%	27%	15%	44%	10%	18%	3%	45%	4%
The reporter is well protected from potential harassment	63%	35%	68%	26%	19%	9%	16%	5%	18%	5%	41%	6%

2.1 Shkalla e raportimit dhe shkaqet kryesore që ndikojnë

Qytetarët janë pyetur nëse janë ndeshur ndonjëherë me akte të dyshuara korruptive nga punonjësit e administratës (Figura 12) nga ku rezulton se shumica e respondentëve në Shqipëri (68,4%) dhe një pjesë në Serbi (41,6%) janë ndeshur ndërkohë që një pjesë e mirë e respondentëve në Kosovë (52,8%) dhe një pjesë në Serbi (42,3%), nuk janë ndeshur. Në të gjitha pyetjet, sidoqoftë, qytetarët e Shqipërisë, ndjehen më të çliruar nga presioni qeveritar për t'u përgjigjur se sa qytetarët e Serbisë dhe Kosovës, ose ndoshta janë më të informuar se ata.

Kosova dhe Serbia kanë një numër të konsiderueshëm respondentësh që zgjedhin të mos përgjigjen, respektivisht 25,8% dhe 16,1%, gjë që tregon se në këto vende ka një stepje për tu përgjigjur, prandaj edhe shifrat e Shqipërisë janë me diskrepancë kundrejt tyre.


Figura 12. Aktet korruptive nga punonjësit e administratës



Qytetarët janë pyetur nëse kanë raportuar ata vetë apo ndonjë pjesëtar i familjes ndonjë akt korruptiv nga punonjësit e administratës gjatë tre viteve të fundit (Figura 13), nga ku rezulton se shumica e respondentëve nga të tre vendet nuk kanë raportuar akt korruptiv, respektivisht 87,6% në Serbi, 78,04% në Kosovë dhe 52,2% në Shqipëri.

Megjithatë, Shqipëria ka shifrën më të lartë të respondentëve që konfirmojnë se kanë kryer raportim (37,5%). Kjo shifër mund të vijë si pasojë e mënyrës se si zyrtarët e kanë kërkuar rryshfetin ku në Shqipëri përgjithësisht kërkohej nga vetë zyrtari (e analizuar më lartë) dhe kjo mënyrë e drejtpërdrejtë ndonjëherë nuk është e pritshme dhe tregon mungesë të drejtpërdrejtë integritet dhe çon në raportim të menjëhershëm.

Figura 13. Raportimi i akteve korruptive



Zgjedhja për të mos raportuar rastet korruptive influencohet nga arsye të ndryshme, prandaj respondentët janë pyetur të vlerësojnë arsyet e mosraportimit me një shkallë nga 1-5 ku 1 – nuk ndikon aspak dhe 5 – ndikon shumë.

Në Shqipëri dhe Serbi respondentët vlerësojnë si shkaqet më ndikuese (duke i vlerësuar me ndikon/ndikon shumë) faktin se rastet nuk mund të provohen (66% në Shqipëri dhe 62,9% në Serbi); faktin se nuk do të kishte asnjë përpjekje edhe nëse vendimi do të merrej (73,7% në Shqipëri dhe 66,7% në Serbi) dhe shqetësimet të cilat vijnë si pasojë e hakmarrjes (76,2% në Shqipëri dhe 82,8% në Serbi).

Shifrat e larta të frikës nga hakmarrja janë tepër shqetësuese pasi tregojnë mungesë të theksuar integriteti të zyrtarëve në këto dy vende, i cili sjell problematika të njëpasnjëshme dhe që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me problematikat që shtrohen në të gjithë raportin për korrupsionin/mosraportimin, etj.

Ndërkohë që në Kosovë respondentët shprehen më të rezervuar pasi më shumë se gjysma e tyre zgjedhin të mos përgjigjen apo të qëndrojnë indiferent kundrejt problematikave të shtruar. Kjo indiference mund të vijë nga fakti se edhe në pyetjet e mëparshme Kosova kishte prirjen më të lartë të respondentëve që zgjedhin opsionin nuk e di/refuzoj të përgjigjem, çka do të thotë se mund të vijë si pasojë e mungesës së informacionit për të gjithë procesin e raportimit në përgjithësi të rasteve të dyshuara për korrupsion.

Edhe për këta tregues, numri i personave të cilët nuk kanë dijeni është në shifra shumë të larta krahasuar me dy vendet e tjera.

Tabla 3. Shkaqet e mosraportimit të rasteve korruptive

The main reasons that influence the non-reporting of corruption cases												
Country	Affects it / Affects it a lot			Indifferent			Affect it a little / Does not affect it at all			I do not know		
	AL	XK	RS	AL	XK	RS	AL	XK	RS	AL	XK	RS
Not knowing where to report	53,2%	17%	65,1%	7,3%	25%	8,8%	33,3%	28%	21,4%	6,0%	30%	4,6%
Cases cannot be proved	66%	13%	62,9%	9,8%	25%	17,0%	18,5%	26%	7,1%	5,8%	36%	13,0%
The process is too complex and long	53,9%	11%	64,0%	10,9%	23%	18,5%	27,9%	24%	5,7%	7,3%	42%	11,7%
Corruption is very common	52,7%	14%	57,2%	11,4%	28%	8,8%	30,7%	27%	1,0%	5,1%	31%	23,0%
Bribes can be justified under the current economic situation	44,4%	14%	51,2%	7,8%	24%	10,2%	41%	20%	16,1%	6,9%	42%	22,5%


Investigations cannot be made about the report	66,2%	14%	43,3%	8,7%	21%	21,0%	15,8%	21%	13,7%	9,4%	42%	22,1%
There would be no enforcement even if the decision is made	73,7%	14%	66,7%	8,0%	20%	11,5%	12,9%	24%	5,5%	5,3%	42%	16,3%
Concern about potential harassment and reprisal	76,2%	11%	82,8%	6,2%	31%	2,9%	12,3%	24%	3,1%	5,3%	34%	11,3%

2.2 Problematikat kryesore sa i takon shërbimeve publike bazë

Një fenomen shqetësues me të cilin ndeshen qytetarët në rastet kur ju duhet të kërkojnë ndihmë mjekësore është referimi që ju bëhet nga mjekët e spitaleve shtetërore drejt atyre private ku ato mund të jenë të punësuar. Për këtë arsye respondentët janë pyetur nëse ata apo ndonjë familjar i tyre e ka ndeshur ndonjëherë këtë fenomen (Figura 15). Shifrat më të larta të respondentëve që janë ndeshur me fenomenin rregjistrohen në Kosovë me pak më pak se ½ e tyre (41%), duke u ndjekur nga Shqipëria (24,5%) dhe Serbia (21%).


Këto shifra tregojnë se ka abuzime që bëhen nga personeli mjekësor për përfitimet e tyre personale duke i detyruar pacientët të paguajnë për një shërbim të cilin mund ta marrin falas në spitalin shtetëror. Megjithatë, ana pozitive është fakti se shumica e respondentëve janë shprehur se nuk janë ndeshur me fenomenin (74,6% në Serbi, 50,3% në Shqipëri dhe 44% në Kosovë).

Figura 14. Referimet në spitale private.



Për të vijuar me analizën e referimeve drejt spitaleve private, respondentët të cilët kishin zgjedhur se e kishin ndeshur fenomenin e referimit drejt spitaleve private janë pyetur nëse janë ndeshur me të njëjtin personel në spitalin privat ku janë referuar (Figura 15). Shifrat tregojnë se një pjesë e mirë e respondentëve janë ndeshur me të njëjtin personel kur kanë vizituar spitalin privat (77,3% e respondentëve në Shqipëri, 70% në Kosovë dhe 50,5% në Serbi). Këto shifra alarmante vërtetojnë perfundimin e mësipërm se personeli mjekësor po shfrytëzon postin dhe po referon pacientët drejt marrjes së shërbimeve me pagesë në spitalet private në të cilat personeli referues ka përfitimet e veta, duke i manipuluar me justifikimet e kushteve më të mira të dhomave, shtretërve, personelit, etj.


Figura 15. Referimet dhe personeli.



Përpos shërbimeve mjekësore një tjetër shërbim shumë vital për qytetarët është edhe pajisja me ujë dhe energji elektrike. Për të matur nivelin e korrupsionit për këto shërbime qytetarët janë pyetur nëse mund të reduktojnë faturat e ujit dhe energjisë duke paguar rryshfet (Figura 16) nga ku shumica e respondentëve (75,8% në Shqipëri, 62% në Kosovë dhe 55% në Shqipëri) shprehen se kjo gjë nuk është e mundur. Në Shqipëri situata duket se është paksa më shqetësuese pasi pothuajse 1/3 (26%) e respondentëve deklarojnë se mund t'i ulin faturat duke paguar rryshfet, ndryshe nga përqindjet më të ulëta të dy vendeve të tjera (7% në Kosovë dhe 6,7% në Serbi).

Diçka tjetër që vlen për tu përmendur është fakti se vëmë re një numër të konsiderueshëm respondentësh që zgjedhin të mos përgjigjen për këtë pyetje (31% në Kosovë, 18% në Shqipëri dhe 17,5% në Serbi). Ky hezitim mund të vijë nga frika se mund të kuptohen dhe në disa vende manipulimet apo vjedhjet që kryhen për këto shërbime dënohen me gjobë apo edhe deri me burg.

Figura 16. Reduktimi i faturave nëpërmjet pagesës së rryshfetit




Për të vijuar analizën tone të shërbimit të furnizimit me ujë dhe energji, qytetarët janë pyetur nëse pagesa e rryshfetit sjell përmirësim të qëndrueshmërisë së shërbimit (Figura 17).

Një pjesë e mirë e respondentëve (69,6% në Serbi, 61% në Shqipëri dhe 54% në Kosovë) shprehen se kjo gjë nuk ndodh. Shqipëria ndjek të njëjtin trend si pyetja paraardhëse, duke vijuar të ketë numrin më të lartë të respondentëve të cilët konfirmojnë se pagesa e rryshfetit çon në përmirësim të qëndrueshmërisë (20% në Shqipëri kundrejt 11% në Kosovë dhe 9,8% në Serbi). Kjo qasje e qytetarëve shqiptar të cilët besojnë se ka përmirësim të shërbimit, i shtyn ata të shkojnë më tepër drejt pagesës së rryshfetit, siç shprehet në analizën e mësipërme.

Edhe në këtë rast vihet re një numër i konsiderueshëm respondentësh të cilët zgjedhin të mos përgjigjen (35% në Kosovë, 20,6% në Serbi dhe 19% në Shqipëri). Duke vijuar me arsyetimin e mëparshëm frika nga penalizimi i shtyn respondentët të jenë më të rezervuar në përgjigjet e tyre.

Figura 17. Përnirësimi i qëndrueshmërisë së shërbimit pas pagesës së rryshfetit.



3. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

3.1. Disa perfundime kryesore

Korrupsioni vijon të mbetet në shifra shqetësuese nën optikën e perceptimit qytetar, ku më shumë se $\frac{3}{4}$ e respondentëve në secilin vend (80,4% në Shqipëri, 74,6% në Kosovë dhe 79,4% në Serbi) e konsiderojnë atë një problem serioz dhe shumë serioz për qytetin. Progresi gjatë 10 viteve të fundit shikohet me më shumë pessimizëm në Shqipëri dhe Serbi ku vlerësohet se është më keq dhe shumë më keq se 10 vite më parë nga më shumë se $\frac{1}{2}$ e respondentëve (71,7% në Shqipëri dhe 57,9% në Serbi).

Respondentët në të tre vendet “fajësojnë” më së shumti politikanët si grupi i cili ushtron më tepër korrupsion (të zgjedhur nga 58% e respondentëve në Shqipëri, 52% në Kosovë dhe 46% në Serbi).

Vullneti politik për luftimin e korrupsionit nga qeveritë e vendeve ku është zhvilluar studimi perceptohet në shifra shumë të ulëta (72% e respondentëve në Shqipëri nuk kanë besim tek vullneti politik i qeverisë, 66% në Shqipëri dhe 36% në Kosovë).

Përpjekjet e qeverive për luftimin e korrupsionit vlerësohen si joefektive nga pothuajse $\frac{1}{2}$ e respondentëve në Shqipëri dhe Serbi (58% në Serbi dhe 51% në Shqipëri) dhe pothuajse $\frac{1}{3}$ e respondentëve në Kosovë (33%).

Pothuajse $\frac{1}{2}$ e respondentëve në Shqipëri dhe Serbi deklarojnë se ju është dashur të paguajnë ryshfet për të marrë shërbime bazë, leje apo liçenca, për të përshpejtuar proceset gjyqësore apo për të rishikuar taksat. Në Kosovë ky fenomen ndeshet më rrallë dhe respondentët kanë zgjedhur në shumicën e rasteve të mos përgjigjen.

Skenari kryesor se si ndodh pagesa e ryshfetit në Shqipëri është nëpërmjet kërkesës së drejtpërdrejt apo të nënkuptuar të zyrtarit, konfirmuar nga $\frac{1}{3}$ e respondentëve (34%). Ndërkohë që pothuajse $\frac{1}{2}$ e respondentëve në Serbi (48%) konfirmojnë se dihet paraprakisht se sa dhe si duhet të kryhet pagesa, pa patur nevojë të diskutohet. Në Kosovë gjërat duket se janë 50/50 midis dy skenarëve të mësipërm (26% skenari i parë dhe 27% skenari i dytë).

Pjesa dërrmuese e respondentëve në të tre qytetet nuk dinë se çfarë procesi duhet ndjekur për të raportuar një akt korruptiv (69,8% në Serbi, 69,7% në Shqipëri dhe 19% në Kosovë).

Më shumë se $\frac{1}{2}$ e respondentëve në secilin prej vendeve e vlerësojnë sistemin e raportimit të korrupsionit si jo efektiv, të komplikuar dhe ndihen të pambrojtur kundrejt hakmarrjeve të mundshme që mund të vijnë si pasojë e raportimit. Respondentët në Kosovë zgjedhin kryesisht të qëndrojnë indiferent apo të mos ju përgjigjen pyetjeve të këtij lloji.

$\frac{1}{2}$ - $\frac{2}{3}$ e respondentëve (87,6% në Serbi, 78,04% në Kosovë dhe 52,2% në Shqipëri) nuk kanë raportuar kurrë asnjë rast të akteve korruptive me të cilat mund të jenë ndeshur ata apo familjarët e tyre.

- Arsyet kryesore se përse qytetarët zgjedhin të mos raportojnë rastet e korrupsionit janë:
- Është e vështirë që të provohen/sigurohen prova se rasti vërtetë ka ndodhur;
- Nuk ka asnjë përpjeke për përmirësim edhe në rastet kur merren vendime;
- Shqetësimet të cilat vijnë si pasojë e frikës nga hakmarrjet e mundshme;

Një pjesë e respondentëve referohen drejt klinikave private nga mjekët e spitaleve shtetërore ku ata afrohen për të përfituar shërbimin e nevojshëm dhe në këto raste referimi më shumë se $\frac{1}{2}$ e respondentëve (77,3% në Shqipëri, 70% në Kosovë dhe 50,5% në Serbi) konfirmojnë se janë ndeshur me të njëjtin personel në klinikën private ku janë referuar.

3.1. Disa rekomandime kryesore të të anketuarve.

Qyteti i Durrësit (Shqiperi)	Qyteti i Lipjanit (Kosove)	Qyteti Smederevo (Serbi)
<ul style="list-style-type: none"> Rekomandimi i cili ka marrë aprovimin më të lartë sa i takon pëlqimit të qytetarëve është “Të gjithë punonjësit publik duhet të nënshkruajnë një kod sjelljeje i cili tregon parimet e sjelljes me qytetarët”. Afishimi i të drejtave qytetare në të gjitha zyrat është një tjetër politikë e cila preferohet nga të anketuarit dhe që konsiderohet e vlefshme prej tyre. 80.09% e të intervistuarve mendojnë se zbatimi i një rekomandimi të tillë do të rezultonte mjaft efektiv ose shumë efektiv. Të intervistuarit (79.3%) mendojnë se krahas kodit të sjelljes dhe afishimit të të drejtave, trajnime më të mira për punonjësit publik për tu dhënë atyre njohuritë dhe mjeshtritë e nevojshme duhen aplikuar në mënyrë që cilësia e përgjithshme e shërbimeve që marrin nga sektori të rezultojë me një rritje domethënëse. Duke marrë në konsideratë dy rekomandimet e mësipërme shohim se të gjitha drejtimit të çojnë drejt faktit se mungon sjellja e duhur nga ana e administratës si dhe trajnimet e nevojshme që ky personel duhet që të ketë. Si mjet parandalues kërkohet që qytetarët të vihen në djeni për të drejtat që kanë duke mundësuar afishimin e tyre në të gjitha zyrat. Në të njëjtën linjë me përgjigjet pararendëse, të intervistuarit duket se shohin rritjen e pagave si mënyrën më të mirë për të parandaluar korrupsionin. Respektivisht 76.6% e të anketuarve mendojnë se kjo masë do të ishte mjaft efektive dhe shumë efektive. Nisur edhe nga shkalla e ulët e ankimimeve të intervistuarit rekomandojnë që të zhvillohen procedura më të mira apelimi dhe ankimimi për qytetarët (74.4% e të intervistuarve) si edhe procedura më të mira dhe funksionale për ankimimin në gjykata kundër veprimeve të punonjësve publik (72.1% e të intervistuarve). 	<ul style="list-style-type: none"> Ndër rekomandimet themelore të qytetarëve figurojnë ato që kanë të bëjnë me seriozitetin e trajtimit të ankesave. Aktualisht, ekziston një përshtypje shumë e përhapur se problemet që qytetarët i hasin në ballafaqimin e tyre me aksin institucional, përfshirë praktikën korruptive dhe keqpërdorimet eventuale momentale, pothuajse në të shumtën e rasteve trajtohen në mënyrë jo serioze. Qytetarët rekomandojnë një përkushtim më të madh të institucioneve publike, për të vepruar konkretisht, shpejt dhe për të sjellë përfundime konkrete në lidhje me ankesat apo kallximet e shtruara, si dhe për të mbajtur të informuar qytetarët rreth epilogut të atyre ankesave, si një domosdoshmëri për të rritur shkallën e besimit të tyre në ankimim. Qytetarët e Komunës së Lipjanit në një masë të caktuar e perceptojnë korrupsionin si një fenomen të rëndomtë, diçka që ekziston si një marrëdhënie e mbyllur në mes akterëve të praktikës korruptive, i cili si fenomen, është edhe vështirë i argumentuar dhe si rezultat, ka një demotivim për të kërkuar përgjegjësi në rastet kur korrupsioni shfaqet si kulturë dhe praktikë pune. Rekomandimi kryesor që derivon nga perceptimet e qytetarëve të Komunës së Lipjanit është ai i rritjes së efikasitetit institucional në trajtimin e rasteve të raportuara, si një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për raportim më të guximshëm dhe më të shpejtë të aferave dhe praktikave ilegale 	<ul style="list-style-type: none"> Rekomandimi që ka marrë miratimin më të lartë (notë mesatare 4.55) për sa i përket pëlqimit të qytetarëve është “Forcimi i kontroleve dhe ndëshkimeve për zyrtarët publikë”. Ky rekomandim është në radhë të parë të masave reformuese për përmirësimin e administratës vendore. Rëndësi më të madhe qytetarët i japin rekomandimit për kontrole dhe ndëshkime më të rrepta të nëpunësve publikë (25.8%), në vend të dytë është: Rritja e pagave të nëpunësve publikë (21.4%). Qytetarët janë të vetëdijshëm se mbajnë një pjesë të mirë të përgjegjësisë për ekzistimin e korrupsionit në ofrimin e shërbimeve publike dhe sepse deklarojnë (12.8%) se “duhet të zbatohen dënime të rrepta për ata qytetarë që japin rryshfet për punonjësit e sektorit publik” dhe ky është një tregues pozitiv i ndërgjegjësimin dhe suksesit të tyre në luftën kundër korrupsionit.

REFERENCA

- Sistemi i Monitorimit të Korrupsionit (CMS), SELDI (2021), i aksesueshëm në: <https://seldi.net/cms-data/cms-methodology/>
- Gjetjet e CMS për vitin e fundit të zbatimit (2021), të aksesueshme në: https://acer.org.al/wp-content/uploads/2021/09/ACER_SELDI_ENG_CMS-2021-FINAL.pdf
- Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI), Transparency International (2022), i aksesueshëm në: <https://www.transparency.org/en/cpi/2022>
- Perceptimi i korrupsionit në Gjeorgji, Anketa e Përgjithshme Publike (2008), e aksesueshme në: <https://rm.coe.int/16806ed5af>
- Treguesit e Qeverisjes në mbarëbotën, Banka Botërore, të aksesueshme në: <https://info.worldbank.org/governance/wgi/Home/Reports>